



**KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

**PËR
PROJEKTLIGJIN**

**“PËR PRANIMIN E INSTRUMENTIT TË AMENDAMENTIT TË KUSHTETUTËS SË
ORGANIZATES NDËRKOMBËTARE TË PUNËS, 1986”**

➤ **HYRJE**

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës, Komisioni për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin Znj. Dajna Sorensen, Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë dhe znj. Luljeta Krasta, Pergjegjëse Sektori në Ministrinë për Financat dhe Ekonominë.

Relatore për këtë projektligj ishte deputetja Znj. Reme Lala.

➤ **BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Pranimi i këtij instrumenti bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

➤ QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është pranimi i instrumentit të amendamentit Kushtetues të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, i cili është miratuar më 4 qershor 1986 nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Organizata Ndërkombëtare e Punës është një agjensi e Kombeve të Bashkuara që merret me problemet e punës, veçanërisht me standartet ndërkombëtare të punës, mbrojtjen sociale, dhe mundësi për punë të barabarta për të gjithë dhe qëllimi i saj është të ndikojë në përmirësimin e punës së denjë dhe drejtësisë për punëtorët si dhe të ofrojë ndihmë teknike për vendet e tjera në zhvillim.

Si shpjegohet edhe në relacionin e paraqitur nga qeveria, ndryshimet në Kushtetutën e Organizatës janë të natyrës procedurale. Ato prekin konkretisht përbërjen dhe drejtimin e trupit drejtues të zyrës, procedurën e caktimit të drejtorit të përgjithshëm, votimin në Konferencën Ndërkombëtare të Punës dhe rregullat e procedurës për amendimin e Kushtetutës.

Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi nëse ratifikohen nga $\frac{3}{4}$ e shteteve anëtare të organizatës, konkretisht nga 125 shtete, 110 prej të cilave e kanë miratuar tashmë.

➤ DISKUTIME NË KOMISION

Gjatë prezantimit të projektligjit Zëvendësministria sqaroi ndryshimet që parashikohen në Kushtetutën e Organizatës, duke i cilësuar ato si ndryshime të natyrës procedurale dhe theksoi rëndësinë e ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

Relatorja për projektligjin Znj. Lala vlerësoi qëllimin e organizatës dhe faktin që projektligji nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit dhe ftoi komisionin ta miratojë atë.

➤ PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nën për nën dhe në tërësi dhe me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORE
REME LALA

KRYETARE
MIMI KODHELI